Instituti i Statistikave
Rr. Vllazën Huta,
Ndërtesa 35, Hyrja 1
Tiranë, Kodi Postar 1017

info@instat.gov.al
www.instat.gov.al
Tel: +355 4 2222 411
Faks: +355 4 2222 411

# Tregtia e jashtme e mallrave

## Maj 2021

**Tiranë, më 16 Qershor 2021:** Në Maj 2021 eksportet e mallrave arritën vlerën 33 mld lekë, duke u rritur me 52,7 %, në krahasim me të njëjtën periudhë të një viti më parë dhe me 14,5 %, në krahasim me Prill 2021. Krahasuar me mesataren mujore të tre viteve, 2018-2020, eksportet në muajin Maj 2021 u rritën me 24,1 %. Importet e mallrave arritën vlerën 62 mld lekë, duke u rritur me 38,4 %, në krahasim me një vit më parë dhe ulur me 1,6 %, në krahasim me Prill 2021. Krahasuar me mesataren mujore të tre viteve, 2018-2020, importet në muajin Maj 2021 u rritën me 15,7 %. Defiçiti tregtar i këtij muaji është 29 mld lekë, duke u rritur me 25,1 %, krahasuar me Maj 2020 dhe duke u ulur me 15,0 %, në krahasim me Prill 2021. Krahasuar me mesataren mujore të tre viteve, 2018-2020, defiçiti tregtar në muajin Maj 2021 u rrit me 7,6 %.

**Fig. 1 Ndryshimi vjetor në Tregtinë e mallrave (%)**




Në pesëmujorin e parë 2021 eksportet e mallrave arritën vlerën 142 mld lekë, duke u rritur me 38,6 %, ndërkohë importet e mallrave arritën vlerën 287 mld lekë, duke u rritur me 30,9 %, krahasuar me një vit më parë. Deficiti tregtar arriti vlerën 145 mld lekë, duke u rritur me 24,2 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të 2020.

**Për publikim 17/06/2021**

*Vijon*

**Kontributi i grupeve kryesore në ndryshimin vjetor të eksporteve:**

Gjatë muajit Maj 2021, në rritjen e eksporteve prej 52,7 %, pozitivisht kanë ndikuar grupet: "Minerale, lëndë djegëse dhe energji elektrike" me +18,6 pikë përqindje, "Materiale ndërtimi dhe metale" me +18,0 pikë përqindje dhe "Tekstile dhe këpucë" me +7,1 pikë përqindje. Ndërsa grupi "Ushqime, pije, duhan" ka ndikuar negativisht me -0,2 pikë përqindje.

Gjatë muajit Maj 2021, rritja e eksporteve prej 24,1 %, krahasuar me mesataren mujore të tre viteve (2018-2020), është ndikuar nga grupet: "Materiale ndërtimi dhe metale" me +9,9 pikë përqindje, Minerale, lëndë djegëse dhe energji elektrike" me +7,7 pikë përqindje dhe "Makineri, paisje dhe pjesë këmbimi" me +4,0 pikë përqindje.

## Kontributi i grupeve në ndryshimin vjetor të eksporteve, Maj 2021




Eksportet, gjatë këtij pesëmujori janë rritur me 38,6 %, krahasuar me një vit më parë. Grupet që kanë ndikuar pozitivisht në rritjen vjetore të eksporteve, janë: "Materiale ndërtimi dhe metale" me +13,7 pikë përqindje, "Minerale, lëndë djegëse dhe energji elektrike" me +11,6 pikë përqindje dhe "Tekstile dhe këpucë" me +6,7 pikë përqindje. Negativisht ka ndikuar grupi: "Prodhime druri dhe letre" me -0,03 pikë përqindje.

**Kontributi i grupeve kryesore në ndryshimin vjetor të importeve:**

Gjatë muajit Maj 2021, në rritjen e importeve prej 38,4 %, krahasuar me Maj 2020, kanë ndikuar pozitivisht grupet: "Makineri, paisje dhe pjesë këmbimi" me +8,7 pikë përqindje, "Materiale ndërtimi dhe metale" me +7,5 pikë përqindje, "Tekstile dhe këpucë" me +5,4 pikë përqindje. Ndërsa grupi "Prodhime druri dhe letre" ka ndikuar negativisht me -0,1 pikë përqindje.

Gjatë muajit Maj 2021, rritja e importeve prej 15,7 %, krahasuar me mesataren mujore të tre viteve (2018-2020), është ndikuar kryesisht nga grupet: “Materiale ndërtimi dhe metale” me +3,9 pikë përqindje, “Makineri, paisje dhe pjesë këmbimi” me +3,4 pikë përqindje, ”Produkte kimike dhe plastike” me +3,1 pikë përqindje.

**Fig.3 Kontributi i grupeve në ndryshimin vjetor të importeve, Maj 2021**




Si pesëmujor, importet janë rritur me 30,9 %, krahasuar me pesëmujorin e parë 2020. Grupet që kanë ndikuar pozitivisht në rritjen vjetore të importeve, janë: “Makineri, paisje dhe pjesë këmbimi” me +10,2 pikë përqindje, “Materiale ndërtimi dhe metale” me +5,4 pikë përqindje, Produkte kimike dhe plastike” me +5,0 pikë përqindje

**Ecuria e tregtisë së mallrave sipas vendeve partnere**

Në muajin Maj 2021, vendet me të cilët Shqipëria ka pasur rritje më të madhe të eksporteve, në krahasim me Maj 2020 janë: Italia (45,4 %), Kosova (102,0 %) dhe Spanjë (5,2 herë). Ndërsa vendet me të cilat eksportet kanë pasur uljen më të madhe janë: Kina (27,7 %), Mbretëria e bashkuar (59,7 %) dhe Ukraina (85,7 %).

Gjatë këtij pesëmujori vendet me të cilët Shqipëria ka pasur rritje më të madhe të eksporteve, në krahasim me një vit më parë, janë: Italia (32,5 %), Kosova (72,2 %) dhe Spanja (30,2 %). Ndërsa vendet me të cilat eksportet kanë pasur uljen më të madhe, janë: Mbretëria e Bashkuar (29,4 %) dhe Ukraina (35,5 %).

Në muajin Maj 2021, vendet me të cilët Shqipëria ka pasur rritje më të madhe të importeve, në krahasim me Maj 2020 janë: Italia (41,9 %), Turqia (51,4 %) dhe Greqia (5,7 herë). Ndërsa vendet me të cilat importet kanë pasur uljen më të madhe janë: Zvicra (34,1 %) dhe Ukraina (69,2 %).

Gjatë këtij pesëmujori, vendet me të cilët Shqipëria ka pasur rritje më të madhe të importeve, në krahasim me një vit më parë, janë: Italia (44,2 %), Turqia (52,8 %) dhe Kina (38,3 %). Ndërsa vendet me të cilat importet kanë pasur uljen më të madhe, janë: Rusia (15,3 %), Zvicra (15,5 %) dhe Ukraina (32,0 %).

**Fig. 4 Tregtia e jashtme e mallrave sipas disa vendeve të BE-së, Maj 2021**




Shkëmbimet tregtare me vendet e BE-së zënë 61,5 %, të gjithë tregtisë. Në Maj 2021, eksportet drejt vendeve të BE-së zënë 69,9 % të eksporteve gjithsej dhe importet nga vendet e BE-së zënë 56,9% të importeve gjithsej. Partnerët kryesorë tregtarë janë: Italia (32,1 %), Turqia (7,3 %), Greqia (6,7 %) dhe Gjermania (6,1 %).

Shkëmbimet tregtare, për katërmujorin e parë 2021, me vendet e BE-së zënë 62,2 % të gjithë tregtisë. Në periudhën Janar – Maj 2021, eksportet drejt vendeve të BE-së zënë 73,1 % të eksporteve gjithsej dhe importet nga vendet e BE-së zënë 56,8 % të importeve gjithsej. Partnerët kryesorë tregtarë janë: Italia (31,9 %), Turqia (7,6 %), Greqia (7,0 %) dhe Kina (6,7 %).

## Tab. 1 Qarkullimi i mallrave, Maj 2021

| Vitet | Muajt | Eksporte (mld lekë) | Ndryshimi Vjetor (%) | Importe (mld lekë) | Ndryshimi Vjetor (%) | Bilanci Tregtar (mld lekë) | Mbulimi (%) |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 2000 | | 37 | -23,5 | 157 | -1,5 | -120 | 23,6 |
| 2001 | | 44 | 19,1 | 190 | 21,0 | -146 | 23,2 |
| 2002 | | 47 | 7,7 | 210 | 10,6 | -163 | 22,6 |
| 2003 | | 54 | 14,7 | 226 | 7,4 | -172 | 24,1 |
| 2004 | | 62 | 14,0 | 236 | 4,5 | -174 | 26,3 |
| 2005 | | 66 | 6,0 | 262 | 11,1 | -196 | 25,1 |
| 2006 | | 77 | 17,6 | 299 | 14,1 | -222 | 25,9 |
| 2007 | | 97 | 25,5 | 376 | 25,8 | -279 | 25,8 |
| 2008 | | 113 | 15,8 | 440 | 16,9 | -327 | 25,6 |
| 2009 | | 105 | -7,2 | 429 | -2,5 | -324 | 24,4 |
| 2010 | | 162 | 54,6 | 478 | 11,4 | -316 | 33,8 |
| 2011 | | 197 | 21,9 | 544 | 13,9 | -347 | 36,2 |
| 2012 | | 213 | 8,2 | 528 | -2,9 | -315 | 40,3 |
| 2013 | | 246 | 15,7 | 517 | -2,1 | -271 | 47,6 |
| 2014 | | 256 | 3,8 | 552 | 6,7 | -296 | 46,3 |
| 2015 | | 243 | -4,9 | 545 | -1,4 | -302 | 44,7 |
| 2016 | | 243 | 0,1 | 579 | 6,4 | -336 | 42,0 |
| 2017 | | 273 | 12,1 | 626 | 8,1 | -353 | 43,6 |
| 2018 | | 310 | 13,7 | 641 | 2,4 | -331 | 48,4 |
| 2019 | | 299 | -3,8 | 649 | 1,2 | -350 | 46,0 |
| 2020 | | 272 | -9,0 | 605 | -6,8 | -333 | 44,9 |
| 2018 | 05 - 18 | 30 | 24,3 | 57 | 2,1 | -27 | 53,1 |
| | Janar– Maj18 | 131 | 109,8 | 255 | 91,8 | -124 | 51,5 |
| 2019 | 05 - 19 | 28 | -8,0 | 59 | 4,0 | -31 | 47,0 |
| | Janar– Maj19 | 127 | -3,5 | 264 | 3,5 | -137 | 48,0 |
| 2020 | 05 - 20 | 22 | -22,5 | 45 | -24,2 | -23 | 48,1 |
| | Janar – Maj20 | 102 | -19,3 | 219 | -17,0 | -117 | 46,7 |
| 2021 | 05 - 21 | 33 | 52,7 | 62 | 38,4 | -29 | 53,0 |
| | Janar– Maj21 | 142 | 38,6 | 287 | 30,9 | -145 | 49,4 |

## Tab. 2 Tregtia e jashtme e mallrave sipas vendeve partnere (milionë lekë), Maj 2021

| | Eksporte | | | | Importe | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Maj 2020 | Maj 2021 | Jan. - Maj 2020 | Jan. - Maj 2021 | Maj 2020 | Maj 2021 | Jan. - Maj 2020 | Jan. - Maj 2021 |
| **Vendet e BE-së** | **15.026** | **22.982** | **77.596** | **103.680** | **25.863** | **35.275** | **125.088** | **162.916** |
| Austri | 110 | 184 | 671 | 902 | 400 | 576 | 1.961 | 2.529 |
| Gjermani | 1.448 | 1.603 | 6.874 | 7.691 | 2.525 | 4.142 | 17.673 | 20.667 |
| Greqi | 863 | 1.758 | 4.610 | 7.673 | 4.334 | 4.583 | 20.574 | 22.460 |
| Itali | 9.260 | 13.460 | 46.378 | 61.458 | 11.950 | 16.963 | 52.181 | 75.269 |
| Spanjë | 473 | 2.463 | 7.381 | 9.612 | 657 | 1.106 | 3.527 | 3.978 |
| Kroaci | 138 | 205 | 759 | 1.177 | 517 | 663 | 2.118 | 2.809 |
| Të tjera të BE-së | 2.733 | 3.308 | 10.921 | 15.166 | 5.480 | 7.243 | 27.053 | 35.204 |
| Mbretëri e Bashkuar | 109 | 44 | 336 | 237 | 435 | 529 | 1.975 | 2.260 |
| Kinë | 644 | 466 | 2.278 | 3.281 | 4.222 | 4.544 | 18.307 | 25.320 |
| Kosovë | 1.897 | 3.834 | 7.931 | 13.656 | 730 | 944 | 2.701 | 3.799 |
| Maqedonia e Veriut | 728 | 1.194 | 3.057 | 4.286 | 697 | 941 | 3.253 | 3.546 |
| Rusi | - | 8 | 6 | 8 | 1.064 | 2.211 | 7.115 | 6.023 |
| SHBA | 269 | 376 | 1.310 | 1.902 | 515 | 1.146 | 3.750 | 5.459 |
| Turqi | 155 | 560 | 851 | 2.555 | 4.199 | 6.357 | 19.786 | 30.232 |
| Ukrainë | 60 | 9 | 229 | 147 | 966 | 298 | 2.163 | 1.470 |
| Zvicër | 34 | 216 | 345 | 1.060 | 757 | 499 | 4.683 | 3.956 |
| Të tjera | 2.594 | 3.169 | 8.331 | 10.961 | 5.309 | 9.200 | 30.384 | 42.052 |
| **Gjithsej** | **21.515** | **32.857** | **102.269** | **141.773** | **44.757** | **61.942** | **219.205** | **287.034** |

## Tab. 3 Tregtia e jashtme sipas grup mallrave (milionë lekë), Maj 2021

| Grup-mallrat | Eksporte | | | | Importe | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Maj 2020 | Maj 2021 | Jan. - Maj 2020 | Jan. - Maj 2021 | Maj 2020 | Maj 2021 | Jan. - Maj 2020 | Jan. - Maj 2021 |
| **Gjithsej** | **21.515** | **32.857** | **102.269** | **141.773** | **44.757** | **61.942** | **219.205** | **287.034** |
| Ushqime. pije. duhan | 4.467 | 4.428 | 14.850 | 16.890 | 8.855 | 10.705 | 44.320 | 46.705 |
| Minerale. lëndë djegëse. en.el. | 2.619 | 6.614 | 15.579 | 27.484 | 3.175 | 5.410 | 20.992 | 25.145 |
| Produkte kimike dhe plastike | 544 | 821 | 2.776 | 3.830 | 7.714 | 9.440 | 34.105 | 45.174 |
| Lëkurë dhe artikujt prej tyre | 148 | 172 | 887 | 1.146 | 1.120 | 1.610 | 4.894 | 5.899 |
| Prodhime druri dhe letre | 553 | 742 | 3.298 | 3.269 | 2.130 | 2.074 | 9.001 | 10.144 |
| Tekstile dhe këpucë | 8.234 | 9.761 | 38.822 | 45.664 | 5.665 | 8.064 | 25.769 | 34.692 |
| Materiale ndërtimi dhe metale | 2.894 | 6.773 | 13.891 | 27.906 | 5.654 | 9.020 | 29.335 | 41.103 |
| Makineri. pajisje dhe pj. kёmb. | 1.434 | 2.581 | 9.088 | 11.428 | 8.962 | 12.865 | 43.173 | 65.464 |
| Të tjera | 622 | 964 | 3.079 | 4.156 | 1.482 | 2.755 | 7.616 | 12.708 |

**Tab. 4 Të dhënat progresive të eksporteve sipas grup mallrave dhe partnerëve kryesorë (milionë lekë), Maj 2021**

| | Itali | | Kosovë | | Spanjë | | Gjermani | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | 2020 | 2021 | 2020 | 2021 | 2020 | 2021 | 2020 | 2021 |
| **Gjithsej** | **46.378** | **61.458** | **7.931** | **13.656** | **7.381** | **9.612** | **6.874** | **7.691** |
| Ushqim. pije duhan | 3.497 | 4.289 | 1.473 | 1.606 | 456 | 673 | 527 | 523 |
| Minerale. lëndë djegëse. energji elektrike | 436 | 685 | 1.124 | 3.233 | 6.332 | 8.657 | 419 | 2.348 |
| Produkte kimike dhe plastike | 768 | 975 | 812 | 1.224 | 65 | 15 | 23 | 34 |
| Lëkurë dhe artikuj prej lëkure | 737 | 734 | 2 | 8 | 67 | 2 | 4 | 29 |
| Prodhime druri dhe letre | 1.946 | 2.294 | 301 | 312 | 2 | 54 | 217 | 97 |
| Tekstile dhe këpucë | 28.462 | 36.190 | 49 | 83 | 387 | 148 | 3.920 | 3.051 |
| Materiale ndërtimi dhe metale | 4.811 | 8.551 | 3.236 | 5.997 | 53 | 51 | 621 | 503 |
| Makineri. pajisje dhe pjesë këmbimi | 4.454 | 5.742 | 253 | 585 | 7 | 11 | 804 | 930 |
| Të tjera | 1.267 | 1.998 | 682 | 607 | 13 | 2 | 338 | 175 |

**Tab. 5 Të dhënat progresive të importeve sipas grup mallrave dhe partnerëve kryesorë (milionë lekë), Maj 2021**

| | Itali | | Turqi | | Kinë | | Greqi | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | 2020 | 2021 | 2020 | 2021 | 2020 | 2021 | 2020 | 2021 |
| **Gjithsej** | **52.181** | **75.269** | **19.786** | **30.232** | **18.307** | **25.320** | **20.574** | **22.460** |
| Ushqim. pije duhan | 7.822 | 9.112 | 2.305 | 2.730 | 288 | 369 | 6.450 | 6.474 |
| Minerale. lëndë djegëse. enerergji elektrike | 1.418 | 3.954 | 638 | 1.305 | 4 | 8 | 3.958 | 3.123 |
| Produkte kimike dhe plastike | 6.891 | 9.734 | 3.307 | 4.242 | 2.173 | 3.695 | 3.030 | 3.667 |
| Lëkurë dhe artikuj prej lëkure | 4.013 | 4.982 | 76 | 132 | 179 | 249 | 11 | 14 |
| Prodhime druri dhe letre | 2.338 | 2.478 | 1.093 | 1.250 | 299 | 285 | 1.314 | 1.433 |
| Tekstile dhe këpucë | 11.511 | 16.649 | 5.173 | 6.785 | 3.293 | 4.468 | 1.347 | 1.321 |
| Materiale ndërtimi dhe metale | 6.359 | 10.178 | 3.823 | 7.538 | 2.433 | 1.970 | 2.911 | 4.270 |
| Makineri. pajisje dhe pjesë këmbimi | 10.310 | 15.594 | 2.761 | 4.129 | 7.903 | 11.854 | 990 | 1.302 |
| Të tjera | 1.519 | 2.588 | 609 | 2.120 | 1.735 | 2.423 | 565 | 854 |

# Metodologjia

Eksportet janë në përgjithësi mallra të destinuara tek një vend i tretë. të vendosura nën regjimin doganor. në përpunimin pasiv ose të rieksportuar pas përpunimit aktiv.

Vlera F.O.B: Është vlera e mallrave të eksportuara deri në kufirin e vendit eksportues. pra përfshin koston e mallrave të eksportuara dhe shpenzimet deri në kufi të vendit eksportues.

Importet janë në përgjithësi mallra që vinë nga një vend i tretë. të vendosura direkt në qarkullim të lirë ose që qëndrojnë në magazinat e ruajtjes nën procedurat doganore të lejimit për qarkullim të lirë. për përpunim aktiv ose për përpunim nën kontrollin doganor.

Vlera C.I.F: Është vlera e mallrave të importuara dërguar deri në kufirin e vendit importues. pra përfshin koston e mallit edhe shpenzimet e transportit dhe sigurimit deri ne kufirin e vendit që importon mallrat.

Nomenklatura e Kombinuar (NK) është një nomenklaturë mallrash e përdorur për statistikat e tregtisë ndërkombëtare të mallrave dhe për tarifat doganore.

http://www.instat.gov.al/al/metodologji/klasifikime-nomenklatura.aspx;

Vendet anëtare të Bashkimit Evropian: Belgjikë. Gjermani. Francë. Itali. Luksemburg. Holandë. Danimarkë. Irlandë. Greqi. Spanjë. Portugali. Austri. Finlandë. Suedi. Qipro. Çeki. Estoni. Hungari. Letoni. Lituani. Maltë. Poloni. Sllovaki. Slloveni. Bullgari. Rumani. Kroaci.

**Shpjegimi i simboleve**

(0) vlerë më e vogël se gjysma e njësisë matëse

(-) pa vlerë

(÷) deri